



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 18, datë 17. 07. 2009

**PËR**  
**“MIRATIMIN E FINANCIMIT TË KUOTËS SË ANËTARËSIMIT TË**  
**BASHKISË SË TIRANËS NË ECAD (RRJETI I QYTETEVE EUROPIANE**  
**KUNDËR DROGËS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 1/V, gërma “b” dhe “c”, nenit 15, pika 5 dhe nenit 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.75, datë 21.05.1999 për “Anëtarësim në Organizatën e Qyteteve Europiane Kundër Drogës”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratohet financimi i kuotës, që Bashkia e Tiranës do t'i paguajë ECAD, si anëtare e ECAD Network (Rrjeti i Qyteteve Europiane Kundër Drogës), në shumën 300 (treqind) Euro në vit duke filluar nga viti 2009 e në vijim.
2. Efektet financiare për vitin 2009 në zbatim të pikës 1, të përballohen duke pakësuar fondin e projekteve sociale miratuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës (konvertuar sipas kursit ditor të Bankës së Shqipërisë).
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Financë Administratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**

